L I G J
Nr.8052, datë 21.12.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7889, DATË 14.12.1994 "PËR STATUSIN E INVALIDIT"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Komisionit te Arsimit, Shkencës, Çështjeve Sociale dhe Shërbimeve Publike,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994 " Për statusin e invalidit", bëhen këto ndryshime:

- Neni 4 ndryshohet si vijon: "Invalidët pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Dëshmia lëshohet nga Shoqata e Invalidëve të Punës, në bazë të KMAC"

- Në nenin 8, në pikën 1, gërma a, mbas fjalëve " mjete lëvizëse" shtohen fjalët "përfshi dhe autovetura" .

- Neni 9 ndryshohet si vijon:

" Në shtëpitë ekzistuese të pushimit shteti në marrëveshje me subjektet që i kanë në pronësi cakton një kontingjent vendesh për pushimin e invalidëve.

Në vendet e përshtatshme klimaterike, shteti cakton sipërfaqe të lira për ndërtimin e kampeve të pushimit dhe qendrave të rehabilitimit për invalidët. Rregullat e financimit për ndërtimin e tyre vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave".

- Në nenin 14, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon: "Rregullat e punësimit dhe ripunësimit të invalidit caktohen me ligj të veçantë".

- Në nenin 19, në fund të pikës 2, në vazhdim shtohen fjalët: "individualisht ose nëpërmjet shoqatave që mbrojnë interesat e tyre."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1347, datë 4.1.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha